



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tirana, Shqipëri

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 7/6 Prot.

Tiranë, më 30 . 01 .2015

VENDIM

Nr. 7 , datë 30 . 01 .2015

Në mbështetje të neneve 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, mbi verifikimin e kryer në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, të aktit të refuzimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen ***** ,

VËREJ:

Në datën 12.12.2014, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni për veprimin administrativ të Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me refuzimin e konfirmimit të statusit, për nëpunësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** .

Duke qenë se në dokumentacionin e administruar rezultuan të dhëna që nuk krijojnë bindje të plotë për drejtësinë e veprimit administrativ të Departamentit të Administratës Publike në lidhje me refuzimin e konfirmimit të statusit si nëpunëse civile, Komisioneri me urdhërin nr. 7/1 prot., datë 17.12.2014, filloi procesin e verifikimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga administrata e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, rezultoi se:

Nëpunësja ***** , ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në vitin 1999, në pozicionin “Specialiste” në Departamentin e Gjeoinformatizimit. Më 1 Mars 2003, është emëruar Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, detyrë të cilën ka vazhduar ta kryejë deri në datën 06.03.2014 , sic rezultojnë nga përmbajtja e listë pagesëve të muajit Shkurt dhe Mars 2014, si dhe nga librezat e punës.

Ristrukturimi i institucionit i kryer në zbatim të VKM nr. 465, datë 13.02.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” si dhe Urdhëri nr. 4, datë 30.01.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për miratimin e kriterëve të punësimit të punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar sipas pozicioneve të punës të strukturës së

miratuar”, e ka gjetur nëpunësen ***** , në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”.

Me aktin administrativ nr. 228, datë 24.02.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm “Emërimet dhe transferimet në detyrë”, kjo nëpunëse është liruar nga detyra e mësipërme dhe ka kaluar në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”, i cili kategorizohet e paguhej si pozicion pune me arsim të mesëm.

Nga ana e institucionit, bazuar në ligjin nr. 8366, datë 02.07.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, është propozuar struktura e re, e cila është miratuar me VKM nr. 228, datë 23.04.2014. Në të, ndër të tjera, ka ndryshuar edhe kategorizimi i pozicioneve të punës, të konsideruara deri në atë kohë si pozicione të kategorisë teknik i mesëm (edhe pse në këto pozicione punonin specialistë me arsim të lartë), duke përputhur natyrën e punës me arsimin e me pagesën, e për rrjedhojë duke i përfshirë në këtë mënyrë në shërbimin civil.

Për zbatimin e strukturës së miratuar me VKM nr. 228, datë 23.04.2014, është ngritur komisioni i ristrukturimit të institucionit, i cili në relacionin drejtuar Departamentit të Administratës Publike, i ka kërkuar këtij të fundit, konfirmimin e statusit të nëpunësit civil, për gjithë punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të cilët u vlerësuan prej tij pjesë e shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike, në përgjigjen kthyer me shkresën nr. 1353/3 dt. 30.06.2014, në lidhje me konfirmimin e statusit të nëpunësit civil për punonjësit e këtij institucioni, për punonjësen ***** , nuk është shprehur duke nënkuptuar në këtë mënyrë, refuzimin e statusit, me arsyetimin se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, pozicioni i saj i punës, nuk ka qënë përfshirë në shërbimin civil.

Nga analiza e dokumentacionit lidhur me procedurën e refuzimit të konfirmimit të statusit të nëpunësit civil, për punonjësen ***** , konstatohet se:

Nëpunësja ***** , ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në vitin 1999 në pozicionin “Specialiste” në Departamentin e Gjeoinformatizimit dhe në 1 Mars 2003 është emëruar Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, detyrë që ka vazhduar ta kryejë deri në datën 06.03.2014.

Në mbështetje të ligjit nr. 8366, datë 02.07.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar” i ndryshuar, Rregullores së funksionimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të miratuar nga METE dhe strukturës së miratuar me VKM nr. 465, datë 13.02.2013, Drejtori i Përgjithshëm i SHGJSH ka nxjerrë Urdhërin nr. 4, datë 30.01.2014, “Për miratimin e kriterëve të punësimit të punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar sipas pozicioneve të punës të strukturës së miratuar”, në të cilin specifikon që Përgjegjësi i Sektorit të Përpunimit të të Dhënave të ketë arsim të lartë për Informatikë, Gjeoinformatikë, duke u pasqyruar më pas edhe në strukturën e re, miratuar me VKM nr. 228 dt. 23.4.2014.

Me aktin nr. 228 prot., datë 24.02.2014, “Emërimet dhe transferimet në detyrë” të Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësja ***** lirohet nga detyra e Përgjegjëses së Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit dhe emërohet “Specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”. Edhe pse emërtesa që është përdorur në këtë akt është “specialiste” që, në kuptim të ligjit presupozon një pozicion pune që përfshihet në shërbimin civil, nëpunësja ***** është emëruar efektivisht në detyrën “Teknik i specialiteteve të ndryshme gjeolog”, që është pozicioni i karakterit teknik, i cili nuk përfshihet në shërbimin civil. Nga verifikimi i bërë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar rezultoi se, në momentin e daljes së këtij akti, në këtë drejtori nuk kishte vakant asnjë nga pozicionet “specialist”, por një pozicion “Teknik i specialiteteve të ndryshme”, dhe u pretendua se përdorimi i emërimit “specialist” në këtë rast, ishte një gabim i bërë nga ana e punonjësit të njësisë të personelit që ka formuluar aktin e emërimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se kalimi efektiv i nëpunëses në fjalë në pozicionin Specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit është kryer në datën 06.03.2014, siç është shprehur dhe në aktin e emërimit nr. 228 prot., datë 24.02.2014, ku është përcaktuar data e mësipërme, si ditë e fillimit të efekteve të tij. Nisur nga ky fakt, rezultoi se në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, punonjësja ***** ka qënë efektivisht në pozicionin Përgjegjëse në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, pozicion në të cilin, për shkak të ligjit, ka fituar edhe statusin e nëpunësit civil në kategorinë e nivelit të ulët drejtues.

Kalimi i kësaj nëpunëseje në pozicionin Specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, i barazvlefshëm ky emërtim me pozicionin “Teknik i specialiteteve të ndryshme gjeolog”, sipas strukturës në fuqi në kohën e kryerjes së kësaj lëvizje (miratuar me VKM 465 dt. 13.2.2013), nuk sjell si pasojë të menjëhershme humbjen e statusit. Ky status pasi fitohet është cilësi e lidhur ngushtësisht me nëpunësin dhe prej tij burojnë një sërë të drejtash dhe detyrimesh që e shoqërojnë atë gjatë gjithë kohës së vazhdimit të marrëdhënies së punës, pavarësisht detyrës konkrete që kryen. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil apo humbja e statusit të nëpunësit civil, ndodh vetëm në rastet e parashikuara në Kreun XII, nenet 63 deri 66, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, kushte që në rastin konkret nuk janë vërtetuar.

Zbatimi i strukturës së re, miratuar me VKM nr. 228, datë 23.04.2014, ka sjellë një element të ri për marrëdhënien e punës së punonjësës ***** . Pozicioni i punës ku ajo punonte efektivisht, në kuadrin e një rivlerësimi të bërë nga Komisioni i Ristrukturimit ngritur me urdhërin nr. 5, dt. 08.05.2014, të Drejtores së Departamentit të Administratës Publike, është përfshirë në shërbimin civil duke u emërtuar “Specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”. Me këtë rast është bërë dhe ndryshimi i kërkesës për këtë pozicion pune, duke kaluar nga arsimi i mesëm në arsim të lartë, kërkesë të cilën punonjësja në fjalë e plotëson.

Sa më sipër, Departamenti i Administratës Publike duhet të konfirmonte statusin e nëpunësit civil të punonjësës ***** në këtë pozicion, pasi me strukturën e re ky

pozicion është përfshirë në shërbimin civil, në kategorinë “nëpunës i nivelit ekzekutiv” dhe punonjësja ***** , edhe pse kishte statusin për një nivel më të lartë të nëpunësisë civile, ka pranuar të punojë në një pozicion me kategori më të ulët.

Në ndryshim nga interpretimi i mësipërm, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1353/3 prot., datë 30.06.2014 “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të SHGJSH”, emrin e nëpunëses ***** nuk e përmend, duke lënë të kuptohet që për këtë punonjëse nuk konfirmohet statusi i nëpunësit civil. Nga korespondenca midis SHGJSH dhe DAP në lidhje me konfirmimin e statusit për punonjësen ***** , si dhe në përgjigjen drejtuar kësaj të fundit, Departamenti i Administratës Publike ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke pretenduar se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nuk ka qenë e emëruar në pozicione të shërbimit civil.

Kjo përgjigje i është bërë e ditur nëpunëses me shkresën nr. 1413 prot., datë 10.11.2014, ku i njoftohet gjithashtu se pozicioni i saj i punës do të shpallet pozicion i lirë për konkurim pranë Departamentit të Administratës Publike dhe marrëdhëniet e punës me institucionin do të jenë të vlefshme deri në plotësimin e pozicionit sipas legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i Departamentit të Administratës Publike për refuzimin e konfirmimit të statusit, vlerësohet se nuk është në përputhje me përmbajtjen dhe kërkesat e nenit 67 pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikës 1/b të Kreut III të VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Nga sa më sipër, ka rezultuar e provuar se kjo punonjëse, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” në datë 26.02.2014 ka qenë në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit” për një periudhë mbi 1 (një) vit dhe në bazë e për zbatim të nenit 67 pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikës 1/b të Kreut III të VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nëpunësja ***** plotëson kushtet për të përfituar statusin e nëpunësit civil në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, gjendje e cila e shoqëron nëpunësen.

Kalimi në një detyrë të një niveli më të ulët, e përfshirë dhe kjo në shërbimin civil, nuk bën që ajo të humbasë statusin e fituar, por duhej të konfirmohej nëpunëse civile në pozicionin specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit.

Në këto kushte, është e domosdoshme të kryhen veprimet e duhura procedurale-ligjore nga ana e Departamentit të Administratës Publike duke deklaruar konfirmimin e statusit për këtë nëpunëse.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike që, në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së refuzimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet administrative të nevojshme për konfirmimin e statusit të nëpunësit civil në pozicionin “*specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoformatizimit*”.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ lihet afat 15 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, Departamenti i Administratës Publike duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA